

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Ndarja / *el-Infisaal* / الانفصال

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"وَيُحَذِّرُكُمُ اللَّهُ نَفْسَهُ"

“Allahu ju paralajmëron që të ruheni nga Vetja e Tij.” (Ali Imran, 30)¹

Nuk ka asgjë në shkallët (stacionet) që zgjerohet më shumë sesa Ndarja².

Kjo ka tri anë:

E para është një ndarje që është një kusht për Lidhjen³, që është një ndarje nga dy botët⁴, duke pushuar së pari ato, duke pushuar së përfilluri ato, duke pushuar së interesuari për to⁵.

¹ Qëllim mbrapa nisjes me këtë ajet është që të paralajmërohet ndjekësi i shtegut të pastrimit shpirtëror për një lloj ndarjeje që do të tërhiqte mallkim përfundimtar, gjë që ndodh atëherë kur Allahu shkëputet nga robi për shkak të pakujdesisë së tij ose shkeljeve të tij, ose ngaqë parapëlqen të tjerë në vend të Tij, edhe pasi ai të ketë arritur një nga shkallët më të larta.

² Ndarja është kërkimi i lidhjes me Zotin dhe qëndrimi me Të, për Të, dhe nëpërmjet Tij duke u ndarë nga çdo gjë tjetër veç Tij. Kjo, madje, përfshin edhe ndarjen nga të gjitha shkallët (stacionet) për të kaluar në një nivel tjetër, ku ti shtegton për tek Ai vetëm nëpërmjet Tij. Kjo është arsyeja përse shejhu vendosi këtë stacion më lart sesa stacionin e Lidhjes.

³ Shih shkallën paraprake, *el-ittisaal* (Lidhja).

⁴ Nga bota që shihet (*shehadeh*) dhe nga ajo që nuk shihet (*gajb*), ose nga jeta e kësaj bote (dynjaja) dhe nga jeta e përtejme (ahireti).

⁵ Sepse personi duhet të kërkojë vetëm Zotin. Natyrisht, kjo nuk nënkupton që, fjala vjen, ne s’e kemi për gajle shpërblimin e Tij ose nuk interesohemi për të Dërguarin e Tij; kjo nënkupton se ne interesohemi për çfarëdo qoftë tjetër veç Tij nëpërmjet Tij dhe për Të.

E dyta është një ndarje nga të parët e ndarjes që përmendëm. Kjo do të thotë që të mos vëresh në të parët (*shuhuud*) tënd ndonjë gjë që lidh ndarjen tënde me ndonjë gjë⁶.

E treta është ndarja nga lidhja. Kjo është një ndarje nga të parët e lidhjes e cila konkurren me të vërtetën e përparësisë⁷. Kjo sepse edhe ndarja, edhe lidhja, pavarësisht variacioneve të tyre të shumta në emër dhe në formë, kanë hise të barabartë në motivin e gabuar⁸ (të parët e vetvetes).

⁶ Shejhu tha më herët se kjo ndarje çon në lidhjen me Allahun. Me mosvërejtje ai mendon në çfarëdo që ti nuk e sheh si veprim tëndin (të ndarë), por ndarjen tënde nga bota e sheh si një dhuratë nga Ai dhe lidhjen tënde vijuese me Të si një dhuratë tjetër nga Ai.

⁷ Kjo tregon se asgjësimi që shejhu ka për qëllim është e perceptueshme (ndijore), jo ontologjike (llojore). Ai do që ti kthehesh mbrapa në kohë, para kësaj ekzistence, dhe të shohësh Allahun pa ndonjë gjë nga kjo ekzistencë. Të parët e tënd të kësaj përparësie do të vendosë çdo gjë në vendin e vet dhe ti do të shohësh sa kalimtare, sa e varur, dhe sa e lirë është çdo gjë tjetër. Duke njohur shejhun, ne duhet të mendojmë se ai nuk ka pasur si qëllim me këtë atë që dikush mund ta kuptojë si një dënim të të besuarit në ekzistencën e vërtetë ontologjike të krijesave. Ata pohojnë se ai mendoi se s'ka ekzistencë tjetër përveç ekzistencës hyjnore, që është besimi i monizmit ontologjik (*wahdeh*) dhe nga Ehlus-Suneti konsiderohet të jetë herezi.

⁸ Sepse të gjitha rezultojnë nga të parët e vetvetes. Në këtë fazë, që shejhu ia kushton *fanaa*-s (vetasgjësimin), çdo ndjesi të vetvetes ai e sheh si të metë.